Suedi
Sverige

UK International Development
Partnership | Progress | Prosperity

UN WOMEN

FOR ALL WOMEN AND GIRLS

INVESTIMI NË EKONOMINË E PËRKUJDESIT NË SHQIPËRI:

Një investim strategjik për rritje ekonomike, punësim dhe barazi gjinore

Shërbimet e kujdesit janë me rëndësi thelbësore për funksionimin e ekonomive dhe shoqërive, por ato ende vazhdojnë të nënvlerësohen, të marrin investime të pamjaftueshme, dhe të kenë shpërndarje të pabarabartë. Në të gjitha shtetet e Evropës dhe Azisë Qendrore, përfshirë Shqipërinë, trysnitë demografike, shoqërore dhe ekonomike në rritje po krijojnë një nevojë gjithnjë e më urgjente për forcimin e sistemeve të kujdesit. Puna e kujdesit vazhdon të kryhet në mënyrë disproporcionale nga gratë, ndërkohë që moshimi i popullsisë, rënia e numrit të lindjeve, mungesat në fuqi punëtore dhe migracioni po i vënë familjet nën trysni gjithnjë e më të mëdha. Përmirësimi i shërbimeve të kujdesit në Shqipëri nuk përbën thjesht kosto: ai është investim ekonomik inteligjent. Zgjerimi i kujdesit parashkollor për fëmijët dhe i shërbimeve të kujdesit për të moshuarit krijon vende pune, shton pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore, forcon financat publike, dhe mbështet një rritje ekonomike përfshirëse dhe fuqizimin ekonomik të grave. Një investim prej vetëm 0,56% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB-së) mund të arrijë:

PËRFSHIRJEN E AFËRSISHT

45,000

fëmijëve të moshës 0-3 vjeç në shërbimet e kujdesit për fëmijët, që do të përmbushte objektivin e BE-së.

KRIJIMIN E RRETH

11,900

vendeve të reja të punës, nga ***75 për qind*** të të cilave ***do të përfitonin gratë***



2.9 MILIARD LEKË

të ardhura shtesë në vit në buxhetin e shtetit

Kjo është në përputhje të plotë me angazhimet e Shqipërisë ndaj Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-ve) dhe procesit të anëtarësimit në BE, si edhe me angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare të vendit.

Këto konstatime vijnë nga Studimi i UN Women në Shqipëri, i kryer kohët e fundit, i cili shënon zbatimin për herë të parë në Shqipëri të instrumentit të UN Women dhe Organizatës Ndërkombëtare të Punës për përllogaritjen e kostos së politikave të kujdesit në Shqipëri.

PSE KA RËNDËSI EKONOMIA E PËRKUJDESIT?

Shqipëria po përballet me nevoja gjithnjë e më të mëdha për shërbime të kujdesit, ndërkohë që moshimi i popullsisë, rënia e numrit të lindjeve dhe emigracioni vazhdojnë. Megjithatë, shërbimet e kujdesit mbeten ende të pamjaftueshme, duke i ngarkuar familjet, sidomos gratë, me barrën e plotësimit të këtyre boshllëqeve përmes punës së papaguar të kujdesit. Ndonëse përbën një nga shtyllat kryesore të ekonomisë shqiptare, puna e kujdesit vazhdon të jetë në pjesën më të madhe e padukshme në statistikat zyrtare.

Gratë kryejnë **më shumë se pesë herë** punë të papaguar kujdesi sesa burrat

Puna e papaguar e kujdesit është e barabartë me **mbi 1,1 milion vende pune** me kohë të plotë, pothuaj e barabartë me numrin e përgjithshëm të punësimit zyrtar

Vlera e përllogaritur e saj arrin deri në **40,7% të PBB-së,** nga e cila **34,1%** kontribuohet nga gratë

KU JANË BOSHLLËQET?

Krahasuar me objektivin e BE-së, Shqipëria ka boshllëqe të konsiderueshme si në shërbimet e kujdesit për fëmijët ashtu, edhe në ato të kujdesit afatgjatë, nga të cilat preken pothuaj 80.000 individë.

***AFËRSISHT* 39,000**

fëmijë të moshës 0-6 vjeç nuk kanë qasje në kujdes dhe arsim parashkollor

***AFËRSISHT* 38,000**

të moshuar nuk kanë qasje në shërbime të kujdesit afatgjatë

Mbulimi i këtyre boshllëqeve dhe arritja e objektivave të BE-së për qasje në shërbimet e kujdesit do të kushtonte afërsisht 0,56% të PBB-së, ose rreth 13,2 miliard lekë në vit.

SI E SHLYEN VETEN KY INVESTIM?

Krahas forcimit të mirëqenies sociale, zgjerimi i shërbimeve të kujdesit gjeneron të ardhurat e veta ekonomike dhe tatimore përmes krijimit të vendeve të reja të punës, pagave më të larta dhe shtimit të të ardhurave në buxhetin e shtetit:

KRIJIM I VENDEVE TË PUNËS

~11,900
VENDE PUNE TË REJA TË DREJTPËRDREJTA

75%
NË SHËRBIMET E KUJDESIT PËR FËMIJËT

25%
NË SHËRBIMET E KUJDESIT AFATGJATË,

d.m.th. shërbime kujdesi për të moshuarit me humbje të konsiderueshme të aftësive funksionale fizike dhe mendore, ose në rrezik të humbjes së tyre.

TË ARDHURA TATIMORE

~ 2.9 MILIARD LEKË

të ardhura shtesë në vit në buxhetin e shtetit, vetëm nga kontributet e TVSH-së dhe të sigurimeve shoqërore, e barabartë me 0,12% të PBB-së.

RRITJE E PAGAVE DHE FORCIM I EKONOMIVE VENDORE

~ 8 MILIARD LEKË

rritja vjetore e fondit të pagave, pagat, kontributet e TVSH-së dhe të sigurimeve shoqërore që do të paguhen për afërsisht 11.900 personat e punësuar në vende të reja pune në shërbimet e kujdesit

PËRFITIME MË TË GJERA EKONOMIKE DHE SHOQËRORE

Këto investime janë thelbësore për të zgjidhur problemin e kufizimeve në tregun e punës dhe atë të hendekut gjinor që vazhdon të ekzistojë në pjesëmarrjen në forcat e punës. Ndër këto përfitime më të gjera ekonomike dhe shoqërore përfshihen:

GRATË KANË MË SHUMË KOHË TË MARRIN PJESË NË PUNËSIM ZYRTAR

- Reduktohet ngarkesa e punës së papaguar të kujdesit
- Mundësohet hyrja dhe përfshirja në vijimësi e grave në tregun e punës
- Përmirësohen siguria e të ardhurave dhe e pensioneve në të ardhmen

MBËSHTETJE PËR RRITJE EKONOMIKE AFATGJATË

- Shërbimet cilësore të kujdesit në fëmijërinë e hershme mbështesin zhvillimin, arsimimin dhe produktivitetin e ardhshëm të fëmijëve, sidomos të atyre nga familje të pafavorizuara

MBËSHTETJE MË E MADHE PËR NUMRIN NË RRITJE TË PERSONAVE TË MOSHUAR

- Zgjerimi i shërbimeve të kujdesit afatgjatë përmirëson mbështetjen për të moshuarit dhe pakëson trysnitë mbi familjet dhe kujdestarët informalë

PËRPARIM NË ARRITJEN E PRIORITETEVE KOMBËTARE DHE TË BE-SË

Investimi në shërbimet e kujdesit mbështet objektivat e Shqipërisë lidhur me barazinë gjinore, mbrojtjen sociale, kapitalin njerëzor dhe integrimin evropian.

Investimet në shërbimet kujdesit janë në përputhje me:

- Objektivat e Strategjisë së BE-së për Kujdesin
- Strategjinë e BE-së për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit për
- Barazi Gjinore (PVBGJ IV), ku ekonomia e përkujdesit identifikohet si prioritet kyç
- Reformat në fushën e mbrojtjes sociale që po kryhen në Shqipëri
- Dialogun aktual ndërmjet OKB-së dhe qeverisë shqiptare mbi përshpejtimin e angazhimeve ndaj barazisë gjinore (OZHQ 5) në kuadër të zhvillimit të kapitalit njerëzor



DY FJALË MBI STUDIMIN

Kjo fletë informative bazohet në studimin e UN Women "Ndryshimi i paradigmës: Kujdesi si investim në Shqipëri – Analizë kosto-përfitim për adresimin e boshllëqeve në mbulimin e shërbimeve të kujdesit". Studimi përdor instrumentin e UN Women dhe ILO për përllogaritjen e kostos së politikave të kujdesit për të vlerësuar boshllëqet në shërbimet e kujdesit dhe të arsimimit në fëmijërinë e hershme dhe në shërbimet e kujdesit afatgjatë për personat e moshuar në Shqipëri, dhe përllogarit koston e mbulimit të këtyre boshllëqeve dhe vlerën e punës së papaguar të kujdesit kundrejt përfitimeve ekonomike që do të gjeneronte ky investim, ndër të tjera, në vende pune dhe të ardhura tatimore. Shifrat bazohen në Censin e Popullsisë dhe të Banesave të vitit 2023, Anketën e Përdorimit të Kohës të vitit 2011 dhe Anketën e Kostos së Punës të vitit 2022.